



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, dhe neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.4, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2023, mori këtë

V E N D I M

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Barazi Gjinore Komunitete, sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0053366/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Barazi Gjinore, të miratuar nga Kuvendi i Komunës më 30 qershor 2022, dhe atë:

- **znj.Lirika Maliqi**, anëtare i Kuvendit të Komunës nga radhët e LVV, emërohet anëtare e Komitetit për Barazi Gjinore, në vend të znj.Drita Pajaziti, e cili ka dhënë dorëheqje nga cilësia e anetares të Komitetit për Barazi Gjinore, përkatësisht është emëruar anëtare në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Neni 2

Ky Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot.01-020/04-0053366/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Barzi Gjinore, të datës 30 qershor 2022.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren QRK nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-020/04-0008900/23
Podujevë, datë, 31 janar 2023



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha